

**D E K R E T**  
**Nr.1510, datë 28.6.1996**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7928, DATË 27.4.1995 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8070, DATË 15.2.1996**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**D E K R E T O J :**

Neni 1

Neni 19 ndryshohet si vijon:

"1. Furnizimi është një furnizim i përjashtuar, nëse ai përcaktohet në nenet 20 deri në 25 dhe në nenet 25/1, 25/2, 26/1 e 26/2.

2. Ministri i Financave ka të drejtë të caktojë me udhëzim se cili prej furnizimeve të përjashtuara nga nenet 20 deri 25 dhe nga nenet 25/1, 25/2, 26/1 e 26/2 të këtij ligji nuk është një furnizim i përjashtuar në kushte e rrethana të përcaktuara".

Neni 2

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje :

"a) Furnizimi i shërbimeve që kryhen nga kontraktorët e nënkontraktorët e tyre, vërtetuar si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve, lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure.

b) Furnizimi i mallrave që bëjnë kontraktorët për njëri-tjetrin ose nënkontraktorët për kontraktorët e tyre, të importuara sipas nenit 26/1 të këtij ligji.

"Operacionet hidrokarbure", për efekt të këtij paragrafi, ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet"."

Neni 3

Pas nenit 25/1 shtohet neni 25/2 me këtë përmbajtje:

"Furnizimi i grurit, i miellit për bukë masive dhe i bukës masive, si dhe i gazit të lëngët për ngrohje për popullsinë, janë furnizime të përjashtuara".

Neni 4

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

"Është furnizim i përjashtuar nga TVSH:

Importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre në të gjitha rrethanat brenda vendit është një furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Importimi i mallrave të vendosura në regjimin e tranzitit.

Importimi i mallrave të deklaruara për të qenë nën regjimin e lejimit të përkohshëm dhe atë të përpunimit aktiv.

Importimi i mallrave dhe i shërbimeve që lidhen me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione. Kontraktorët dhe nënkontraktorët vërtetohen si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve.

"Operacione hidrokarbure", për efekt të këtij paragrafi, ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet".

Neni 5

Pas nenit 26/1 shtohet neni 26/2 me këtë përmbajtje:

"Është furnizim i përjashtuar nga TVSH:

- importimi i grurit dhe i miellit për bukë masive për popullsinë;
- importimi i vajgurit dhe i gazit të lëngët për popullsinë."

Neni 6

Përjashtimet e parashikuara sipas neneve 25/2 dhe 26/2 shfuqizohen me liberalizimin e çmimeve të shitjes së këtyre mallrave.

Neni 7

Ky dekret hyn në fuqi më 1.7.1996.

KUNDËRFIRMOHET  
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
**Sali Berisha**